



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1 Janar, Shkurt 2019

Index:

Aktivitete 2

Aktivitete 3

Aktivitete 4

Sensibilizim 6

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES KMD DHE INSPEKTORIATIN SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda dhe Arben Seferaj, kryeinspektori i Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nënshkruan me datë 23 janar të 2019 Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për të bashkërenduar të gjitha veprimet për të realizuar mbrojtjen e qytetarëve kundrejt diskriminimit në punë.

Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimin, Gajda vuri në dukje se nënshkrimi i kësaj marrëveshje është institucionalizimi midis palëve për sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit, sinjalizimit të rasteve diskriminuese e bashkëpunimit midis dy Institucioneve, në kuadër të marrjes së masave pro aktive për mbrojtjen nga Diskriminimi në Punësim dhe Fushën e Shërbimeve Shoqërore si dhe për promovimin e parimit të barazisë.

Marrëveshja parashikon trajtimin e ankesave në Zyrën e KMD si dhe Inspektime të përbashkëta në raste të caktuara.

Ka shumë për të bërë, ne po punojmë çdo ditë për objektivat tona.

Komisioneri Gajda në takimin e Aleancës për Dhurimin e Gjakt



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në takimin e Aleancës për Dhurimin e Gjakt, në analizën e punës për 6 mujorin e saj të parë, nën drejtimin e presidentit të Republikës, z. Ilir Meta.

Zyra e KMD, si shumë institucione të tjera publike është përfshirë në fushatën kombëtare për nxitjen e sa më shumë qytetarëve që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjshëm për rëndësinë e dhurimit të gjakut për njerëzit në nevojë në spitale.

Kush dhuron gjak, dhuron jetë!

**DHURO GJAK.
SHPËTO
NJË JETË!**

Tryeza e rumbullakët e Institucioneve të Pavarura, me ministren e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në tryezën e rumbullakët të drejtuesve të Institucioneve të Pavarura organizuar nga ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Elisa Spiropali.

Roli bashkërendues i Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin me institucionet e pavarura, Kuvendin e Shqipërisë dhe ekzekutivin synon të forcojë impaktin e institucioneve dhe ndjekjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve, si dhe përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues.

Komisioneri Gajda vlerësoi takimin koordinues si një provë angazhimi për të garantuar të drejtat e Njeriut, në të gjitha aspektet.



Komisioneri Gajda takim pune me Zv/ Ambasadorin e Greqisë në Tirane Z. Delavekouras, Këshilltar i Parë.



Të dy palët theksuan se respekti për të drejtat e njeriut dhe në veçanti të minoriteteve është përparësi për çdo shtet që dëshiron të sillet një mënyrë moderne dhe demokratike.

Ligji për minoritet është një sipërmarrje e rëndësishme. U vlerësua pozitivisht miratimi i ligjit mbi pakicat kombëtare dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes dhe garantimin e të drejtave të tyre në praktikë. Gjithashtu, u diskutuan çështje specifike lidhur me vetë-identifikimin e pakicave, arsimimin në gjuhën amëtare, pjesëmarrjen në jetën publike, ekonomike, sociale dhe përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës së nevojshme në përditshmërinë e minoritetit.

Zv. Ambasadori shprehu nevojën e prezantimit të Insitucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi pranë minoritetit si dhe implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Një garanci me shumë për mbrojtjen e pakicave përbën Ligji Nr. 10221 “Për mbrojtjen

nga diskriminimi”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u krijua bazuar në këtë ligj, si institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Mbi Luftën Kundër i Diskriminimit dhe Mbrojtja e të Drejtave LGBTI në Shqipëri.

Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në një takim të organizuar nga Coc Holande dhe Komiteti i Helsinkit (NHC) mbi Luftën Kundër i Diskriminimit dhe Mbrojtja e të Drejtave LGBTI në Shqipëri.

Ky projekt financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës në kuadrin e vartëses së saj të MATRA. Programi Matra është ngritur për të forcuar kapacitetin e institucioneve qeveritare në disa vende në fazën e para-anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe ato të Partneritetit Lindor, për të nxitur zhvillimin e tyre të shtetit të të drejtës në përputhje me kriteret e pranimin në BE nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet (gjysmë) publike holandeze. Sa për kujtesë, Kapitulli 23 i negociatave të pranimin në BE me Shqipërinë, ndër të tjera, përcakton respektimin e lirive themelore, duke përfshirë të drejtat e njeriut të personave LGBTI, të cilët shpesh janë viktimë të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe madje edhe krimeve të urrejtjes.



Komisioneri Gajda takim z.Gjurgjaj, përfaqësues i shoqatës maqedonase "Ilinden"



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim z.Nikolla Gjurgjaj, përfaqësues i shoqatës maqedonase "Ilinden" Tiranë.

Z. Gjurgjaj informoi Komisioneri Gajda me punën aktuale dhe angazhimet që zhvillon shoqata në minoriteti kombëtar maqedonas në Republikën e Shqipërisë.

Në qendër të takimit ishte mbështetja dhe promovimi i ligjit për pakicat kombëtare, promovimi i kulturave dhe implementimi në ditën e përditshme të aspekteve të ligjit, që ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit.

Komisioneri Gajda vuri në dukje se "çdo person, që i përket një pakice kombëtare, ka të

drejtën të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje".

Po ashtu, ai garantoj se Institucionet publike, qendrore dhe vendore janë të angazhuara për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës.

Në fund të takimit, një çështje që u prek ishin edhe ankesat e paraqitura pranë KMD nga shoqata si dhe takimet në muajin Mars me pakicat kombëtare në territoret banuese.

"Fuqizimin e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrjen politike"

Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në seminarin mbi: "Fuqizimin e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrjen politike", të organizuar nga Women's Democracy Network, WDN. Aktiviteti i cili vjen pas disa seminare në nivel lokal ishte një hapësirë shkëmbimi idesh dhe përvojash nga gra nga i gjithë spektri partiak në nivel vendor dhe qendror, njëkohësisht me pjesëmarrje të gjerë edhe nga aktorët e shoqërisë civile që punojnë kryesisht në fushën e bazazisë gjinore dhe atë të zgjedhjeve. Përveç vlerësimit dhe arritjeve në kuadër të reformave të ndërmara u theksua se mbetet ende shumë për tu bërë deri në realizimin e një kuadri më të plotë ligjor në lidhje me mundësitë e barabarta që mungojnë dhe i privojnë grate në angazhimin politik në Shqipëri.

Komisioneri Gajda takim me drejtoreshën e UNDP-së, znj. Limya Eltayeb



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Robert Gajda priti në një takim drejtoreshën e UNDP-së, znj. Limya Eltayeb.

Komisioneri Gajda informoi znj. Eltayeb për ecurinë e zyrës së KMD për 2019, jo vetë në Tiranë, por edhe në zyrat rajonale për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë në shoqëri.

Nga ana e saj, drejtoresha e UNDP-së, znj. Limya Eltayeb vuri në dukje rolin nxitës së KMD dhe punën e përbashkët për të rritur pjesëmarrjen e komunitetit rom dhe egjiptian në proceset e zhvillimit gjithëpërfshirës në institucionet publike në vend.

Komisioneri Gajda garantoj përfaqësuesin e lartë të UNDP për vëmendjen maksimale për mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të Njeriut në vend, ku së shpejti do të dalë për publikun edhe raporti i cili ka për qëllim të sjellë në vëmendje, nevojën për një kuptim të drejtë të diskriminimit, për identifikimin, adresimin dhe gjykimin e tij, në mënyrë që të rritet efektiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes prej tij.

Komisioneri Gajda takim me znj. Freedberg zv.drejtor i Human Rights Campaign



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda takoi në Tiranë znj. Jean Freedberg zv.drejtor i Human Rights Campaign (HRC), për të biseduar rreth komunitetit LGBTI, në vend dhe problematikave të ndryshme. Znj. Freedberg, e cila po mbledh avokatë nga i gjithë rajoni për të ndarë idetë dhe praktikat më të mira për mënyrën e angazhimit të punëdhënësve dhe bizneseve në avancimin e barazisë.

Gjatë një pritjeje të organizuar në bashkëpunim me Open Mind Spectrum Albania Omsa, Komisioneri Gajda dhe znj. Freedberg u njohën me disa biznese locale mbështetëse të dialogut më të gjerë për bashkëpunimin midis sektorit të biznesit dhe komunitetit LGBTI.



Marrëveshje bashkëpunimi KMD dhe ANAD



Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD).

Duke qënë se Komisioneri është institucioni që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke qënë se (Sh.K.Sh.Nj.ND) zhvillon veprimtarinë, për njerëzit që nuk dëgjojnë duke avokuar për mbrojtjen e të drejtave dhe përmirësimit e cilësisë së jetës së tyre;

Me synimin e përbashkët për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për personat që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë; si dhe krijimin e aksesit në informacion në gjuhën e shenjave shqipe për të siguruar informacionin e nevojshëm të shërbimeve publike në funksion të një jetese të pavarur.

Me objektiv garantimin e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, sigurimin e të drejtës së çdo personi për, akses të përshtatur në informacion, në gjuhën e shenjave shqipe ,

barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, për personat që nuk flasin .

Me angazhimin për të asistuar njeri-tjetrin mbi parimin e reciprocitetit, dhe me bindjen se bashkëveprimi është në ndihmën dhe interesin e qytetarëve

Do të bashkëpunojme për të siguruar informacion për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Gjuhën e Shenjave në Shqipe, e njohur zyrtarisht me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 837, datë 03.12.2014.

Do të bashkëpunojme për ofrimin e një shërbimi të plotë ligjor, të ofruar në gjuhën e shenjave shqipe për të gjithë personat që nuk dëgjojnë apo familjarët e tyre, që paraqesin ankesa për diskriminim pranë tyre. Do të bashkëpunojnë në organizimin e fushatave të përbashkëta sensibilizuese dhe trainimeve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi, minimizimin e rasteve të diskriminimit, mbrojtjen e të drejtave të LGBTI .



DITA NDËRKOMBËTARE E GRAVE DHE VAJZAVE NË SHKENCË

Përdorimi i gjuhës diskriminuese në media mbi minoritetin rom, egjiptian dhe pakicat e tjera kombëtare

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesën në takimin e organizuar nga Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome mbi temën “Përdorimi i gjuhës diskriminuese në media, e cila prek veçanërisht minoritetin rom, egjiptian dhe pakicat e tjera kombëtare. Komisioneri Gajda vuri në dukje nevojën për eliminimin e stereotipeve nga ana e medias dhe nxitjen për promovimin e vlerave pozitive të komuniteteve.

Luftimi i gjuhës së urrejtjes ndaj grupeve

vulnerabël dhe komuniteteve të ndyshme po kthehet në një domosdoshmëri për punën e zyrës së KMD.

Komisioneri Gajda bën thirrje për më shumë kujdes me përdorimin e gjuhës dhe shmangia e krahasimeve negative, përçmuese dhe denigruese referuar komuniteteve.





Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:
www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit, ish gjykata administrative e Apelit. Tiranë

Zip Code: 1019

E-mail: info@kmd.al

Tel:

Komisioneri: + 355 4 243 1077

Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1

Zip Code: 4001

Tel: + 355 4 243 1078

Gjirokastër: Ish "Shtëpia e Oficerave" ADISA

Zip Code: 6001

Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1

Zip Code: 7001

Tel: + 355 4 243 1078